

# BULETINI INFORMATIV



Gjatë muajit qershor, Enti Rregullator i Energjisë (ERE) ka vijuar ushtrimin e kompetencave të tij ligjore në funksion të rregullimit, monitorimit dhe zhvillimit të sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror. Në kuadër të veprimtarisë së Bordit dhe administratës së ERE-së janë ndërmarrë një sërë vendimmarrjesh dhe aktiviteteve që lidhen me licencimin e operatorëve, monitorimin e tregut, zhvillimin e kuadrit rregullator, bashkëpunimin institucional dhe informimin e publikut.

Në këtë numër të newsletter-it janë përmbledhur zhvillimet kryesore të muajit, duke përfshirë procedurat e licencimit dhe ndryshimet në licenca, publikimet zyrtare, të dhënat mbi tregun e energjisë elektrike, çmimet e shitjes së energjisë elektrike, si dhe aktet dhe dokumentet rregullatore që ndodhen në proces konsultimi publik.

Në përmbushje të misionit të tij institucional, ERE mbetet e angazhuar për garantimin e një kuadri rregullator të qëndrueshëm, transparent dhe të parashikueshëm, duke nxitur zhvillimin e një tregu energjetik konkurrues, të sigurt dhe në përputhje me standardet evropiane.

Për më shumë informacion mbi vendimet e Bordit, aktet rregullatore dhe aktivitetet e institucionit, vizitoni faqen zyrtare të ERE-së: [www.ere.gov.al](http://www.ere.gov.al).

## LICENCIME

### Procedura të filluara gjatë muajit qershor 2026

ERE nis procedurat e licencimit për katër projekte të reja të prodhimit të energjisë elektrike. Gjatë muajit qershor, Enti Rregullator i Energjisë (ERE) ka filluar procedurat administrative për licencimin e katër shoqërive në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, në zbatim të kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi. Procedurat e nisura përfshijnë shqyrtimin e aplikimit për licencimin e shoqërisë "GREENSOL" sh.p.k. për prodhimin e energjisë elektrike nga një impiant fotovoltaik me kapacitet të instaluar 49.96 MW, me vendndodhje në Njësinë Administrative Mesopotam, Bistricë, Bashkia Finiq, Qarku Vlorë. Projekti zhvillohet në bazë të kontratës së nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit fotovoltaik.

Po ashtu, ERE ka nisur procedurën për licencimin e shoqërisë "ASSA ENERGY SOLUTIONS" sh.p.k., për prodhimin e energjisë elektrike nga një impiant fotovoltaik me kapacitet të instaluar 10 MW, me vendndodhje në Sheq Marinas, Bashkia Fier. Projekti realizohet në bazë të Marrëveshjes për Zhvillimin e Projektit të lidhur me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë. ERE ka filluar procedurën e licencimit për shoqërinë "DOMA GROUP" sh.p.k., për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali "Vinjoli 1", me kapacitet të instaluar 1.840 MW, i cili do të ndërtohet në Përroin e Varroshit, Manazdresë dhe Lajthit, degë të Përroit Zall i Madh, në Bashkinë Mat, sipas kontratës së nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Gjithashtu, ka nisur procedura e licencimit për shoqërinë "GLOBAL INTERPRISE GROUP" sh.p.k., për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali "Doma", me kapacitet të instaluar 1.695 MW, në Përroin e Lusës, degë e Lumit Mat, Bashkia Klos, Qarku Dibër, në përputhje me kontratën përkatëse të lidhur me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë. Në kuadër të zhvillimit të tregut të energjisë elektrike, ERE ka filluar gjithashtu procedurën për licencimin e shoqërisë "NEXORA" sh.p.k. në veprimtarinë e tregut të energjisë elektrike, duke zgjeruar numrin e operatorëve që synojnë të ushtrorjnë aktivitet në tregun shqiptar të energjisë. Fillimi i këtyre procedurave pasqyron angazhimin e ERE për të garantuar zbatimin e standardeve ligjore dhe rregullatore në procesin e licencimit, duke mbështetur zhvillimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga burimet e rinovueshme, si dhe rritjen e konkurrencës dhe funksionimin efikas të tregut të energjisë elektrike në Shqipëri.

# BULETINI INFORMATIV



## Vendime licencimi

Gjatë muajit qershor 2026, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE) vendosi të licencojë shoqërinë “SPV Blue 3” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaik “Blue 3”, me kapacitet të instaluar 36 MW, me vendndodhje në Sheq Marinas, Bashkia Fier.

Licenca është dhënë për një afat 30-vjeçar, i cili fillon nga data e kolaudimit të veprës, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

Projekti bazohet në Marrëveshjen për Zhvillimin e Projektit për projektimin, financimin, ndërtimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e impiantit fotovoltaik “Blue 3”, me kapacitet të instaluar dhe të mbështetur prej 36 MWac, të nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive “BLESSED INVESTMENT” sh.p.k. dhe “Matrix Konstruksion” sh.p.k..

Dhënia e kësaj licence përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt vënies në funksion të një kapaciteti të ri prodhues nga burime të rinovueshme, duke kontribuar në diversifikimin e burimeve të energjisë, rritjen e prodhimit vendas dhe mbështetjen e objektivave kombëtare për zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit energjetik.

## Vendime modifikim licence

Bordi i ERE-s gjatë muajit qershor, ka vendosur modifikimin e licencës së shoqërisë “5GX ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 135, datë 09.07.2024, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 10 MW, duke shtuar veprat ndihmëse/njësitë e depozitimit të energjisë elektrike në Aneksin A të licencës, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit. Me heret nëpërmjet Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 272, datë 04.05.2023 dhe Kontratës nr. 2175 rep., nr. 484 kol., datë 23.06.2023, të nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) shoqëria është pajisur me të drejtën për miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në zonën kadastrale nr. 1020, Fshati Allprenaj, Njësia Administrative Golem, Bashkia Lushnjë, Qarku Fier.

## Vendimmarrjet e Bordit të ERE gjatë muajit qershor

Gjatë muajit qershor 2026, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE) zhvilloi 5 mbledhje vendimmarrëse, të njoftuara publikisht të paktën 24 orë përpara zhvillimit të tyre, në përputhje me parimet e transparencës dhe informimit të publikut. Njoftimet u publikuan në faqen zyrtare dhe në rrjetet sociale të institucionit, duke u mundësuar të gjitha palëve të interesit ndjekjen online të mbledhjeve.

Gjatë këtyre mbledhjeve, Bordi miratoi gjithsej 30 vendime, të cilat trajtuan një gamë të gjerë çështjesh rregullatore, ndër to fillimin e procedurave të reja të licencimit, dhënien dhe modifikimin e licencave, autorizime, pezullimin ose zgjatjen e afateve procedurale, si dhe miratimin e çmimeve, tarifave dhe akteve të tjera rregullatore në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror.

Për të garantuar informimin në kohë të publikut dhe transparencën e procesit vendimmarrës, pas çdo mbledhjeje është publikuar një përmbledhje e vendimeve të miratuara në kanalet zyrtare të komunikimit të ERE-së. Ndërkohë, tekstet e plota të vendimeve janë të disponueshme në faqen zyrtare të institucionit, në rubrikën “Vendime”, si dhe publikohen në Fletoren Zyrtare, sipas legjislacionit në fuqi.

# BULETINI INFORMATIV



## Vendime për zgjatjen e afatit të vendimmarrjes

Gjatë muajit qershor 2026, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE) miratoi disa vendime për zgjatjen e afatit të vendimmarrjes, në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, me qëllim administrimin e plotë të procedurave dhe shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur nga subjektet aplikuese dhe palët e interesit. Në kuadër të procedurave për transferimin e licencës dhe asetëve, Bordi vendosi zgjatjen deri në 30 ditë të afatit të vendimmarrjes për shqyrtimin e kërkesës për transferimin e licencës së shoqërisë “DRINI BULQIZE” sh.p.k., dhënë me vendimin nr. 77, datë 29.04.2024, për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC “Polemi”, me kapacitet të instaluar 1.751 MW, në favor të shoqërisë “HEC Polemi” sh.p.k.. Po ashtu, u zgjat me 30 ditë edhe afati për shqyrtimin e kërkesës për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin e asetëve të paluajtshme të HEC “Polemi” nga shoqëria “DRINI BULQIZE” sh.p.k. te shoqëria “HEC Polemi” sh.p.k.. Zgjatja e afatit u vlerësua e nevojshme për t’i mundësuar ERE-së zhvillimin e korrespondencës vijuese me shoqërinë dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), si dhe administrimin e informacionit dhe dokumentacionit shtesë të kërkuar, në funksion të një shqyrtimi të plotë të kërkesave dhe marrjes së një vendimmarrjeje të bazuar në të gjitha elementet teknike dhe ligjore të çështjes.

Gjatë muajit qershor, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE) vendosi fillimin e procedurës për modifikimin e licencës së shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k., e licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike me vendimin nr. 289, datë 13.11.2025, nga një central fotovoltaik me kapacitet të instaluar 8.8 MW.

Kërkesa për modifikim konsiston në përfshirjen në Aneksin A të licencës të veprave ndihmëse, përfshirë njësitë e depozitimit të energjisë elektrike (Battery Energy Storage Systems - BESS), pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit fotovoltaik.

Në përputhje me Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të ndryshuar, ERE ka bërë publike njoftimet përkatëse për të gjitha procedurat e licencimit dhe modifikimit të licencave të nisura gjatë kësaj periudhe.

Njoftimet janë publikuar në median e shkruar, në faqen zyrtare të institucionit [www.ere.gov.al](http://www.ere.gov.al), si dhe në kanalet zyrtare të ERE-së në Facebook, Instagram dhe LinkedIn, me qëllim garantimin e transparencës së procesit dhe krijimin e mundësisë për paraqitjen e komenteve apo objeksioneve nga çdo palë e interesuar përpara marrjes së vendimeve përfundimtare nga Bordi.

## Fillim procedure për modifikimin e licencës

Gjatë muajit qershor, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE) vendosi fillimin e procedurës për modifikimin e licencës së shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k., e licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike me vendimin nr. 289, datë 13.11.2025, nga një central fotovoltaik me kapacitet të instaluar 8.8 MW.

Kërkesa për modifikim konsiston në përfshirjen në Aneksin A të licencës të veprave ndihmëse, përfshirë njësitë e depozitimit të energjisë elektrike (Battery Energy Storage Systems - BESS), pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit fotovoltaik.

Në përputhje me Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të ndryshuar, ERE ka bërë publike njoftimet përkatëse për të gjitha procedurat e licencimit dhe modifikimit të licencave të nisura gjatë kësaj periudhe. Njoftimet janë publikuar në median e shkruar, në faqen zyrtare të institucionit [www.ere.gov.al](http://www.ere.gov.al), si dhe në kanalet zyrtare të ERE-së në Facebook, Instagram dhe LinkedIn, me qëllim garantimin e transparencës së procesit dhe krijimin e mundësisë për paraqitjen e komenteve apo objeksioneve nga çdo palë e interesuar përpara marrjes së vendimeve përfundimtare nga Bordi.

## Vendime heqje licence

Gjatë muajit qershor 2026 ka vendosur të heqë licencën për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “KORKIS-2009” sh.p.k me vendimin e bordit të ERE-s nr. 21, datë 04.03.2011, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Belesova 1” me fuqi 0.150 MW dhe HEC “Belesova 2” me fuqi 0.280 MW , për arsye të mos shlyerjes të pagesave të rregullimit ndaj ERE-s.

# BULETINI INFORMATIV



## Vendime ndryshim vendimmarrjeje

### Ndryshime në vendime licencimi për projekte të prodhimit të energjisë elektrike

Gjatë muajit qershor 2026, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE) miratoi disa ndryshime në vendime licencimi, në kuadër të monitorimit të zbatimit të kushteve të licencave dhe administrimit të procedurave rregullatore për projektet e prodhimit të energjisë elektrike.

Në rastin e shoqërisë “RENEW” sh.p.k., Bordi vendosi ndryshimin e vendimit nr. 68, datë 08.04.2025, të ndryshuar, për licencimin e saj në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga një central fotovoltaik me kapacitet prodhues 2 MW. Projekti zhvillohet në bazë të kontratës së nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit fotovoltaik dhe veprave ndihmëse në Njësinë Administrative Topojë, Bashkia Fier. Pas verifikimit të dokumentacionit të paraqitur dhe konstatimit se shoqëria kishte përmbushur të gjitha kushtet e vendosura në vendimin e licencimit, përfshirë përfundimin e punimeve, njoftimin e institucioneve përgjegjëse dhe fillimin e ushtrimit të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda afateve të përcaktuara, Bordi vendosi shfuqizimin e kushteve përkatëse të vendosura në licencë.

Gjatë muajit qershor 2026, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE) miratoi disa ndryshime në vendimin nr. 197, datë 15.08.2025, duke vendosur refuzimin e kërkesës së shoqërisë “KËLCYRA 2020” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Klisyrë”, me kapacitet prodhues 2 MW, me vendndodhje në Zonën Kadastrale 2170, Klisyrë, Bashkia Tropojë, për një afat 30-vjeçar.

Ky vendim u mor pas administrimit të qëndrimit zyrtar të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), e cila informoi ERE se nuk kishte miratuar zgjerimin e kapacitetit prodhues të HEC-it ekzistues “Klisyrë” në 2 MW. Ky informacion nuk ishte në dispozicion të ERE-së në momentin e shqyrtimit fillestar të aplikimit për licencim dhe përbënte një element thelbësor për rivlerësimin e çështjes.

Nga ana tjetër, Bordi konstatoi se shoqëria “KËLCYRA 2020” sh.p.k. është pronare e HEC “Klisyrë”, në bazë të kontratës së shitjes së pasurisë së paluajtshme. Në këto kushte, dhe në zbatim të nenit 37, pika 6, shkronja “b” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, sipas të cilit prodhuesit e lidhur me rrjetin kombëtar me kapacitet të instaluar deri në 1 MW nuk janë të detyruar të pajisen me licencë për ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, shoqëria mund të vijojë ushtrimin e veprimtarisë për kapacitetin e miratuar, pa qenë e nevojshme pajisja me licencë nga ERE.

Ky vendim garanton përputhshmërinë e procesit të licencimit me aktet administrative të autoriteteve kompetente dhe me kërkesat e legjislacionit në fuqi, duke siguruar zbatim të njëtrajtshëm të kuadrit rregullator në sektorin e energjisë elektrike.

Gjithashtu, Bordi miratoi ndryshimin e vendimit nr. 158, datë 05.06.2026, për fillimin e procedurës së licencimit të shoqërisë “GREENSOL” sh.p.k., pas përditësimit të projektit të centralit fotovoltaik me kapacitet të instaluar 49.96 MW, me vendndodhje në Njësinë Administrative Mesopotam, Bistricë, Bashkia Finiq, Qarku Vlorë. Përditësimi i projektit përfshin edhe veprat ndihmëse, përfshirë njësitë e depozitimit të energjisë elektrike, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit. Në këtë fazë të procedurës, ERE pranoi për shqyrtim përfshirjen e këtyre veprave ndihmëse vetëm në funksion të kapacitetit të instaluar prej 49.96 MW, ndërsa shqyrtimi i plotë i aplikimit do të vijojë në përputhje me procedurat e parashikuara në kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, duke përfshirë edhe procesin e konsultimit me palët e interesit.

Këto vendimmarrje dëshmojnë rolin e ERE në monitorimin e vazhdueshëm të zbatimit të kushteve të licencimit, përshtatjen e projekteve me zhvillimet teknologjike të sektorit dhe administrimin transparent të procedurave rregullatore, duke garantuar që zhvillimi i projekteve energjetike të realizohet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet e kërkuara teknike e rregullatore.

# BULETINI INFORMATIV

## Vendime për zgjatjen e afatit të vendimmarrjes

Gjatë muajit qershor 2026, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE) miratoi disa vendime për zgjatjen e afatit të vendimmarrjes, në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, me qëllim administrimin e plotë të procedurave dhe shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur nga subjektet aplikuese dhe palët e interesit.

Në kuadër të procedurave për transferimin e licencës dhe asetëve, Bordi vendosi zgjatjen deri në 30 ditë të afatit të vendimmarrjes për shqyrtimin e kërkesës për transferimin e licencës së shoqërisë “DRINI BULQIZE” sh.p.k., dhënë me vendimin nr. 77, datë 29.04.2024, për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC “Polemi”, me kapacitet të instaluar 1.751 MW, në favor të shoqërisë “HEC Polemi” sh.p.k.. Po ashtu, u zgjat me 30 ditë edhe afati për shqyrtimin e kërkesës për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin e asetëve të paluajtshme të HEC “Polemi” nga shoqëria “DRINI BULQIZE” sh.p.k. te shoqëria “HEC Polemi” sh.p.k.. Zgjatja e afatit u vlerësua e nevojshme për t’i mundësuar ERE-së zhvillimin e korrespondencës vijuese me shoqërinë dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), si dhe administrimin e informacionit dhe dokumentacionit shtesë të kërkuar, në funksion të një shqyrtimi të plotë të kërkesave dhe marrjes së një vendimmarrjeje të bazuar në të gjitha elementet teknike dhe ligjore të çështjes.

Gjithashtu, Bordi vendosi zgjatjen deri në 30 ditë të afatit të vendimmarrjes për kërkesën e shoqërisë “ERSEKA SOLAR PARK 1” sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga një central fotovoltaik me kapacitet të instaluar 20 MW, me qëllim shtimin e veprave ndihmëse, përfshirë njësitë e depozitimit të energjisë elektrike, në Aneksin A të licencës, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit. Zgjatja e afatit u vendos për t’i mundësuar Bordit shqyrtimin e plotë të objeksioneve të paraqitura gjatë procesit të konsultimit publik, si dhe të parashtrimeve të depozituara nga shoqëria në përgjigje të tyre.

## AUTORIZIME PËR GARANCI FINANCIARE

Gjatë muajit qershor 2026, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE) miratoi disa vendime në lidhje me dhënien dhe administrimin e autorizimeve për garanci financiare, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi


### Autorizim për vendosjen e kuotave si garanci financiare

Bordi i ERE vendosi të japë autorizimin për vendosjen e kuotave të shoqërisë “Infotelecom-Albsolar 4” sh.p.k. si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimeve ndaj institucionit kredidhënës “Intesa Sanpaolo Bank Albania” sh.a.. Ky autorizim është dhënë në përputhje me dispozitat ligjore që rregullojnë vendosjen e garancive mbi pjesëmarrjet në kapitalin e shoqërive të licencuara, duke siguruar njëkohësisht mbrojtjen e interesit publik dhe vijueshmërinë e ushtrimit të veprimtarisë së licencuar.

### Shfuqizim i autorizimit për garanci financiare

Në të njëjtën periudhë, Bordi i ERE vendosi të shfuqizojë vendimin nr. 199, datë 15.08.2025, “Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë “RENEW” sh.p.k. si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj “ProCredit Bank” sh.a.. Shfuqizimi i këtij vendimi u miratua në përputhje me rrethanat dhe dokumentacionin e administruar në kuadër të procedurës përkatëse.

# BULETINI INFORMATIV



## TREGU I ENERGJISË

Kapacitetit total prodhues të energjisë elektrike të instaluar në vendin tonë gjatë muajit maj i janë shtuar 3 centrale fotovoltaike dhe 1 central hidrik të listuara si më poshtë:

- “GREEN ENERGY” sh.p.k. - central fotovoltaike me vendndodhje në qarkun Fier me kapacitet të instaluar 2 MW
- “DESLA” sh.p.k. - central fotovoltaike me vendndodhje në qarkun Durrës me kapacitet të instaluar 3 MW
- “POWER ENERGY” sh.p.k. - central fotovoltaike me vendndodhje në qarkun Fier me kapacitet të instaluar 25 MW
- Centrali hidrik HEC “Shiroku” me vendndodhje në qarkun Elbasan me kapacitet të instaluar 1.6 MW, i cili operohet nga shoqëria “DELIU 3D” sh.p.k.

Shoqëritë “GREEN ENERGY” sh.p.k. dhe “DELIU 3D” sh.p.k., zotërojnë kontrata shitblerje energjie me “FTL” sh.a. me çmim të rregulluar, ndërsa “DESLA” sh.p.k., dhe “POWER ENERGY” sh.p.k., operojnë në treg të lirë me çmim të parregulluar shitblerje energjie.

Prodhimi neto i realizuar nga HEC-et e Kaskadës së Drinit për këtë muaj është 358,106 MWh ose rreth 42% më shumë energji elektrike e prodhuar se muaji maj i vitit të kaluar. Niveli i liqenit të Fierzës i cili është bazeni kryesor në kaskadën e lumit Drin në fillim muaji arriti kuotën prej 294.85 mmnd ndërsa fundi i muajit u mbyll në nivelin 296.36 mmnd. Sikurse evidentuar përgjatë këtij muaji kemi rritje të nivelit të ujit në liqenin e Fierzës prej rreth 1.51 metër. Prurjet mesatare mujore në këtë liqen rezultuan 203 m<sup>3</sup>/sek ndërsa rezerva energjitike për kaskadën e Drinit në fund të muajit maj ishte 1511.6 GWh.

Përgjatë këtij muaji shoqëria publike “KESH” sh.a. nuk ka pasur shkarkime pa prodhim energjie nga portat e HEC-eve në kaskadë si dhe nuk ka kryer procedura blerjeje energji elektrike në treg të parregulluar sipas detyrimit për shërbimin publik të vendosur në VKM 456/2022, e ndryshuar.

Gjatë muajin maj kushtet e favorshme hidrologjike mundësuan krijimin e tepricave për tregtim në tregjet rajonale. Në këtë kuadër, KESH sh.a., realizoi shitjen e 111,083 MWh energji elektrike me një çmim mesatar prej 84.16 EUR/MWh, Si rezultat, të ardhurat totale të përfituara nga aktiviteti i shitjes së energjisë përgjatë këtij muaji arritën në 11.19 milionë EUR.

Balanca neto e shkëmbimit të energjisë elektrike për muajin maj rezultoi 242,499 MWh (dalje), si diferencë e eksportit të realizuar në sasinë prej 429,475 MWh dhe importit të realizuar në vlerën 186,976 GWh.

Humbjet e përgjithshme të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike për këtë muaj arrijnë në 13.94%, ndërsa ato të sistemit të transmetimit në vlerën 1.99 %.

Në të gjitha tregjet e ALPEX-it u tregtuan gjithsej 208,234.19 MWh energji elektrike, ndërsa rrjedha ndërkufitare arriti në 78,755.57 MWh. Në Tregun e Ditës në Avancë u tregtua një volum total prej 202,906.62 MWh energji elektrike, me një çmim klerues mesatar prej 89.95 €/MWh ndërsa në Tregun e Ankandeve Brenda të Njëjtës Ditë u tregtua gjithsej 5,327.57 MWh me një çmim mesatar ditor klerues prej 92.91 €/MWh. Numri i Anëtarëve të Bursës ishte 47, të cilët morën pjesë në Tregun e Ditës në Avancë, ndërsa 33 prej tyre edhe në Tregun e Ankandeve Brenda të Njëjtës Ditë. Numri i Anëtarëve të Përgjithshëm të Klerimit arriti në 6.

## REMIT

Në përputhje me “Rregulloren për Integritetin dhe Transparencën e Tregut me Shumicë të Energjisë (REMIT)”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 126, datë 17.05.2021, si dhe me Ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, ERE ka vijuar me përditësimin e të dhënave mbi regjistrimin e pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike që hyjnë në transaksione me shumicë në Shqipëri (Regjistri REMIT). Për vitin 2026, numri total i shoqërive të regjistruara në regjister është 104. Përgjatë muajit qershor janë regjistruar 5 subjekte, respektivisht shoqëritë: “EZ-5 ENERGY” sh.p.k., “HP OSTROVICA ENERGY” sh.p.k., “PREMIUM GREEN ENERGY” sh.p.k., “HIDRO INVEST 1” sh.p.k. dhe “IDI 2005” sh.p.k. Ky regjister gjendet i publikuar dhe i përditësuar në faqen zyrtare të ERE-s.

# BULETINI INFORMATIV

## VENDIME PËR ÇMIMET DHE TARIFAT

### Çmimi i shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit

Në mbledhjen e datës 12.06.2026 Bordi i ERE-s miratoi çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin maj 2026, në vlerën 14.05 Lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.

Ky çmim rezulton më i lartë krahasuar me muajin prill 2026, i cili ishte 12.75 lekë/kWh.

Çmimi i shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit (FMF) është variabël dhe ndryshon nga muaji në muaj, si pasojë e ndryshimeve në koston e blerjes së energjisë në tregun e lirë për furnizimin e klientëve që marrin shërbimin në kushtet e mundësisë së fundit. Në këtë çmim, kostot e rrjetit dhe kostot administrative mbeten të pandryshuara, ndërsa komponenti kryesor që ndikon në luhatjen është kosto e energjisë së blerë.

Për muajin maj 2026, kosto mesatare e blerjes së energjisë për mbulimin e kërkesës së klientëve të FMF-së ka rezultuar në vlerën 10.28 lekë/kWh, me një sasi të nominuar në bursën e energjisë prej 44.79 MWh. Ndërkohë, për muajin prill 2026, kosto përkatëse ka rezultuar 9.01 lekë/kWh, me një sasi të nominuar prej 209.1 MWh. Në terma krahasues, kosto e blerjes së energjisë për muajin maj 2026 është rritur rreth 14.1% në raport me muajin prill 2026, ndërsa sasia e energjisë së prokuruar për furnizimin e klientëve të lidhur në nivelin e tensionit 35kV është ulur rreth 79%.

Për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV, të cilët furnizohen në kushtet e mundësisë së fundit, çmimi i shitjes së energjisë elektrike mbetet i pandryshuar në nivelin 18.26 lekë/kWh, siç është miratuar nga ERE në muajin shkurt 2026. Ky çmim mbetet fiks, pasi energjia për këtë kategori sigurohet nga KESH sh.a. me një kosto të qëndrueshme furnizimi. Në përmbushje të detyrimeve ligjore dhe për të garantuar transparencë ndaj palëve të interesuara, ERE miraton dhe publikon periodikisht çmimin e llogaritur të shitjes së energjisë elektrike nga FMF, në zbatim të legjislacionit në fuqi.

### Mbi rishikimin e Rregullores për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike.

Me vendimin nr. 165, datë 05.06.2026, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE) miratoi disa ndryshime në Rregulloren për Kriteret Standarde të Cilësisë së Shërbimit të Furnizimit dhe Performancës së Sigurisë së Rrjetit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, në zbatim të Rezolutës së Kuvendit për vlerësimin e veprimtarisë së ERE për vitin 2024 dhe të detyrimeve të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi.

Procesi i rishikimit u zhvillua nëpërmjet një konsultimi të gjerë publik, me pjesëmarrjen e institucioneve shtetërore, operatorëve të sektorit, organizatave të mbrojtjes së konsumatorit dhe aktorëve të tjerë të interesuar. Gjatë kësaj procedure u administruan dhe u shqyrtuan komentet e paraqitura nga palët, një pjesë e të cilave u reflektuan në tekstin përfundimtar të rregullores.

Ndryshimet e miratuara synojnë rritjen e cilësisë dhe besueshmërisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike, përmirësimin e treguesve të performancës së operatorit të sistemit të shpërndarjes, forcimin e mekanizmave të monitorimit dhe kompensimit, si dhe rritjen e transparencës dhe mbrojtjes së konsumatorëve.

Në kuadër të këtyre ndryshimeve janë miratuar objektiva më ambicioze për periudhën 2026–2028 për treguesit kryesorë të performancës, përfshirë SAIDI, SAIFI, kohën mesatare të rikthimit të furnizimit pas defekteve dhe Energjinë e Pafurnizuar (ENS), si dhe janë përditësuar standardet që lidhen me cilësinë e tensionit dhe frekuencës, afatet për lidhjet e reja, njoftimin e ndërprerjeve të planifikuara, trajtimin e ankesave dhe rilidhjen e konsumatorëve.

Përmes këtij vendimi, ERE synon të nxisë përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së operatorit të sistemit të shpërndarjes, të rrisë përgjegjshmërinë ndaj konsumatorëve dhe të harmonizojë standardet kombëtare të cilësisë së shërbimit me praktikatat më të mira evropiane.

# BULETINI INFORMATIV



## Publikime dhe përditësime në webfaqe dhe në rrjetet sociale

Gjatë muajit qershor 2026, Enti Rregullator i Energjisë (ERE) vijoi të zhvillojë një komunikim të vazhdueshëm dhe transparent me publikun, nëpërmjet publikimeve të rregullta në faqen zyrtare [www.ere.gov.al](http://www.ere.gov.al) dhe në kanalet zyrtare në Facebook, Instagram dhe LinkedIn. Gjatë këtij muaji, fokusi i komunikimit institucional ishte informimi në kohë i publikut mbi proceset vendimmarrëse, procedurat rregullatore dhe zhvillimet kryesore në sektorin e energjisë.

Në kuadër të kësaj veprimtarie u publikuan njoftimet për mbledhjet e Bordit të ERE-së, rendet e ditës dhe përmbledhjet e vendimeve të miratuara, duke u mundësuar të gjitha palëve të interesit ndjekjen online të mbledhjeve dhe informimin mbi vendimmarrjet e institucionit. Paralelisht, u publikuan njoftime për aplikimet e reja për licencim dhe modifikim licence, si dhe njoftime për procedurat e konsultimit publik për aktet rregullatore në shqyrtim. Një vend të rëndësishëm në publikimet e muajit zuri edhe komunikimi mbi aktivitetet ndërkombëtare të institucionit, veçanërisht organizimi në Tiranë i Asamblesë së 41-të të Përgjithshme të MEDREG, si dhe vizita teknike e delegacioneve ndërkombëtare në Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST), duke pasqyruar angazhimin e ERE në forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe euro-mesdhetar në sektorin e energjisë. Këto aktivitete u reflektuan gjerësisht në faqen zyrtare dhe në rrjetet sociale të institucionit.

Gjatë muajit u publikuan gjithashtu informacione mbi çmimet e shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, dokumente të konsultimit publik, vendime të Bordit, si dhe u përditësuan vazhdimisht regjistrat elektronikë të ERE-së, përfshirë regjistrin e licencimeve, autorizimeve, procedurave në proces, Programin e Transparencës dhe regjistrin e ankesave të konsumatorëve.

Enti Rregullator i Energjisë (ERE) vijoi procesin e konsultimit publik për një sërë aktesh rregullatore me rëndësi për sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror, duke ftuar operatorët e tregut, institucionet, organizatat e konsumatorëve dhe çdo palë të interesuar të paraqesin komente dhe propozime.

ERE zhvilloi konsultimin publik për propozimin “Për disa ndryshime në Rregulloren për Kriteret Standarde të Cilësisë së Shërbimit të Furnizimit dhe Performancës së Sigurisë së Rrjetit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike”, proces i cili u finalizua me miratimin e ndryshimeve nga Bordi i ERE-së.

Njëkohësisht, në sektorin e gazit natyror, Bordi i ERE-së nisi procedurën për miratimin e disa ndryshimeve në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, miratuar me vendimin nr. 97, datë 04.07.2017. Ndryshimet e propozuara synojnë përafrimin e rregullores me ndryshimet e fundit të ligjit për sektorin e gazit natyror, si dhe përshtatjen e kuadrit rregullator me zhvillimet e reja të tregut, duke përfshirë rregullimin e veprimtarive që lidhen me impiantet me permasa të vogla të Gazit Natyror të Lëngëzuar (GNL) dhe Gazit Natyror të Komprimuar (GNK), procedurat për licencimin me kushte, si dhe riorganizimin e regjistrit të licencave për rritjen e transparencës. Përmes këtyre publikimeve, ERE vijoi të zbatojë parimet e transparencës, llogaridhënies dhe komunikimit të hapur me publikun, duke garantuar akses të plotë në informacion për konsumatorët, operatorët e licencuar, institucionet dhe çdo palë tjetër të interesuar mbi veprimtarinë rregullatore dhe zhvillimet kryesore të sektorit energjetik.

Në webfaqen e ERE-s gjenden të rifreskuar regjistrat e mëposhtëm:

- Kërkesa dhe përgjigje në Programin e Transparencës ([kliko këtu](#))
- Ankesa të konsumatorëve ([kliko këtu](#))
- Licencime ([kliko këtu](#))
- Autorizime ([kliko këtu](#))
- Procedurat e autorizimit në proces ([kliko këtu](#))
- Procedurat e licencimit në proces ([kliko këtu](#))

Për më shumë informacion

Ftojme të gjithë qytetarët, operatorët e tregut dhe palët e interesuara të vizitojnë faqen zyrtare të Entit Rregullator të Energjisë për të aksesuar vendimet e Bordit, aktet rregullatore, dokumentet në konsultim publik, raportet, tarifatat dhe çmimet e energjisë elektrike, si dhe të gjitha publikimet më të fundit të institucionit.

Faqja zyrtare: [www.ere.gov.al](http://www.ere.gov.al)

Ju ftojme gjithashtu të ndiqni ERE në Facebook, Instagram dhe LinkedIn, për t'u informuar në kohë reale mbi vendimmarrjet e Bordit, procedurat e licencimit, konsultimet publike, aktivitetet institucionale dhe zhvillimet më të rëndësishme në tregun e energjisë.